



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 25.1.2022

*Dokument parlamentar*

*Komision përgjegjës*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9723, DATË 3.5.2007,  
“PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR**

***I. Hyrje***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 25.01.2022, mori në shqyrtim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Zj. Blerina Gjylameti.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent:

*Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Z. Besart Kadia Zv. Ministër dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.*

*Nga Qendra Kombëtare e Biznesit: Flogers Broqi, Drejtor i Metodologjisw.*

***II. Baza ligjore Kushtetuese***

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 83 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji mbështetet në nenet 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

### **III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij projektligji, është rishikimi i nivelit/masës së penaliteteve të parashikuara në nenin 74, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, në rastet që lidhen me deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta (kur nuk përbëjnë veçer penale) si dhe moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrime të tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara në ligj nga bizneset.

Rishikimi i masës së këtyre penaliteteve, mundëson adresimin e rekomandimeve të “*Financial Action Task Force*” (FATF) sipas Raport Progresit për Shqipërinë në tetor 2021, (masa 5.3), sipas së cilës, duhet të sigurohet një kuadër ligjor i përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatohen sanksione më proporcionale dhe bindëse, bazuar në treguesin e paritetit të fuqisë blerëse.

Ky rekomandim, bazohet në gjetjet e International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force (ICRG/FATF), që e ka konsideruar masën e penaliteteve aktuale për këto shkelje, të ulta dhe se nuk pasqyrojnë Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe Paritetin e Fuqisë Blerëse (PPP) të Republikës së Shqipërisë. Sipas këtij entiteti në vitin 2007 PBB/frymë ishte në vlerën 9151 USD, ndërsa në 2020 është 13 817.8 USD.

Objektivat që pretendon të realizojë ky projektligj konsistojnë në:

- Vendosja e normave ligjore të forta dhe detyruese për të garantuar deklarimin e të dhënave të vërteta në regjistër nga ana e subjekteve tregtare;
- Vendosja e normave ligjore të forta dhe detyruese për të garantuar kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këto subjekte brenda afateve të parashikuara nga ligji;
- Rritja e konkurrueshmërisë dhe përmirësimi i klimës së biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve;
- Rritja e transparencës lidhur me deklarimet e të dhënave nga bizneset.

#### **Përmbajtja**

Projektligji përmban 2 nene, gjithsej si më poshtë:

- Neni 1 i projektligjit bën ndryshimin i pikave 2 e 3, të nenit 74 të ligjit, konkretisht në pikën 2 vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta dhe në pikën 3, vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara nga ky ligj.

- Neni 2 i projektligjit parashikon dispozitën e hyrjes në fuqi.

#### **IV. Zbatimi i projektligjit:**

Për zbatimin e këtij projektligji do të jetë përgjegjëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

#### **V. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire**

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

#### **VI. Efektet Financiare**

Projektligji mbart efekte financiare por me pamundësi përlllogaritje. Kjo për faktin se nuk dihet nëse do të kemi subjekte që do të shkelin ligjin dhe nëse po cili do të jetë numri i tyre.

Në rastin e subjekteve shkelës, masa e gjobës që do të aplikohet ndaj tyre, do të arkëtohet në buxhetin e shtetit si e ardhur nga gjobat.

#### **VII. Shqyrtimi i projektligjit në komision:**

Përfaqësuesit e Qeverisë bënë një përshkrim të detajuar të projektligjit si dhe të arsyeve se përse është ndërmarrë kjo inisiativë. Apo bërë gjithashtu edhe një prezantim dhe analiza krahasuese me vendet e rajonit lidhur me nivelin e gjobës për shkeljet e referuara në projektligj.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij theksojmë se në parim, përfshirja e penaliteteve në një ligj, ka për qëllim “mbrojtjen” e ligjit nga subjektet që i nënshtrohen fushës së zbatimit të ligjit, e që tentojnë të mos e zbatojnë atë, pra këto penalitete ndihmojnë në parandalimin e shkeljeve dhe garantimin e respektimit të të ligj.

Pavarësisht nga sa më sipër, shkeljet duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese, pra në nivel të tillë që të dekurajojnë shkelësin nga kryerja e saj.

Në këtë kontekst, rritja e masës së penalteteve bazuar në parimet e sipërcituara, vlerësohet se do të ketë ndikim në rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve për deklarimin e të dhënave reale. Gjithashtu ndikim jo të drejtpërdrejtë do të kenë edhe në uljen e numrit të gjobave të vendosura si pasojë e rritjes së vlerës së tyre dhe ndërgjegjësimit të subjekteve si dhe sigurimin e një informacioni të vërtetë dhe të sigurt nga publiku, duke qenë se të dhënat e subjekteve publikohen në web-in e QKB në mënyrë transparente.

Me qëllim përcaktimin e një masë penalteti të përshtatshëm përkundrejt Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP) të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë një analizë të thelluar krahasuese lidhur me aplikimin e gjobave për të njëjtën problematike nga vendet e rajonit.

Nga kjo analizë rezulton se niveli i gjobave i aplikuar nga vende të ndryshme është më i lartë se ai në Shqipëri. Kështu:

- Greqia aplikon gjobat në vlerat 600 euro-3000 euro për shkeljet e bëra në Regjistrin Tregtar;
- Sllovenia aplikon gjobën nga 200 euro-400 euro etj
- Mali i Zi aplikon gjobën prej 1000 euro;
- Serbia aplikon 3 muaj – 5 vjet burg

Vlera mesatare e gjobave të vendosura në rajon rezulton rreth 370 euro.

Referuar këtyre të dhënave, pas krahasimit të masës së gjobës me vendet e tjera dhe nga analizimi i të dhënave përkundrejt Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP) është sugjeruar se vlera më e përshtatshme e gjobës për tu aplikuar në këtë projektligj të jetë 60 000 lekë.

Përfaqësuesit e qeverisë, iu përgjigjën gjithashtu edhe pyetjeve dhe dhanë shpjegimet e nevojshme për anëtarët e komisionit.

## ***VIII. Përfundime***

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se projektligji do të mundësojë adresimin e rekomandimeve të “*Financial Action Task Force*” (FATF) sipas Raport Progresit për Shqipërinë në tetor 2021 si dhe vendosjen e normave ligjore të forta dhe detyruese për të garantuar deklarimin e të dhënave të vërteta në regjistër nga ana e subjekteve tregtare dhe për të garantuar kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këto subjekte brenda afateve të parashikuara nga ligji, me votat pro të shumicës së gjithë anëtarëve të komisionit të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi

**RELATOR**

**Blerina GJYLAMETI**

**KRYETAR**

**Eduard SHALSI**